



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
BASHKIA VLORË  
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. \_\_\_\_\_ prot.

Vlorë, më \_\_\_\_\_ 2023

PROJEKT-VENDIM

Nr. \_\_\_\_\_, datë \_\_\_\_\_ 2023

**“PËR DHËNIEN E MIRATIMIT PËR APLIKIM NGA ANA E BASHKISË VLORË  
PRANË SHOQATËS EUROPIANE ACES EUROPE, PËR MARRJEN E STATUSIT  
QYTETI EUROPIAN I SPORTIT 2024”**

Në mbështetje të ligjit Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” i ndryshuar, Ligjit Nr.79/2017 “Per Sportin” i ndryshuar, kërkojmë nga ana juaj miratimin e aplikimit që Bashkia Vlorë kërkon të kryejë pranë Shoqatës Europiane ACES Europë, për marrjen e statusit “Qyteti European i Sportit 2024”.

**KRYETARI**

**Ermal Dredha**

*Konceptoi dhe punoi: D. Demiri  
Nr. Faqesh 1 (nje)  
Nr. Kopjesh 7 (shtatë)  
Dt. 27.09.2023*

Adresa: Sheshi “4 Heronjtë”, Tel: 033421201; Fax 033421201; [www.vlora.gov.al](http://www.vlora.gov.al); e-mail: [info@vlora.gov.al](mailto:info@vlora.gov.al)

Vlorë, 27 Shtator 2023



11 496

**Këshilli Bashkiak i Bashkisë Vlorë**

**Memorandum: Kandidatura e Bashkisë Vlorë për t'u bërë kandidat zyrtar për çmimin "Qyteti European i Sportit 2024"**

Të nderuar anëtarë të Këshillit Bashkiak,

Bashkia Vlorë po shqyrton promovimin e qytetit në arenën Europiane nëpërmjet kandidaturës për çmimin "Qyteti europian i Sportit 2024". Ky çmim menaxhohet nga shoqata Europiane **ACES Europe** (European Capitals & Cities of Sport Federation) me seli në Bruksel, Belgjikë.

Shoqata **ACES Europe** bashkëpunon me Komisionet Europiane dhe Parlamentin Europian, dhe është një nga shoqatat lider në Europë me mbi 500 anëtarë, me interes në promovimin e sportit, shëndetit dhe aktivitetit fizik për gjithë qytetarët Europian.

Pas Tiranës këtë vit, në rast aprovimi të aplikimit, Vlora do të jetë qyteti i dytë Shqiptar që do t'i akordohet ky çmim prestigjioz. Kjo do të shërbejë si një gjenerator të një kalendari të pasur me aktivitete sportive mbarë Europiane të të gjitha llojeve ku do të marrin pjesë mijëra të rinj e të reja. Disa nga aktivitetet sportive të cilat do të organizohen nepermjet ketij eventit do të jene:

- Maratona të sporteve të ndryshme
- Futboll/Futboll në plazh

- Basketboll/Basketboll ne rruge
- Volejball/Volejball ne plazh
- Tenis
- Atletik
- Ciklizem
- Ping Pong
- Peshengritje
- Not
- Sporti i Velave


Bashkia Vlorë, nëpërmjet këtij eventit, është e gatshme të kontribuojë në promovimin e sportit në nivelet kombëtar dhe Europian dhe e shikon këtë kandidaturë si një mundësi për zhvillimin e infrastrukturës tonë sportive dhe për të kultivuar vlera si toleranca, loja e drejtë dhe stili i shëndetshëm i jetesës.

Gjithashtu, për të qënë kandidat zyrtar për çmimin e sipërpërmendur Bashkia duhet të arkëtojë në shoqatën ACES Europe shumën prej 2,350 (dy mijë e tre qind e pesëdhjetë) Euro.

Duke marrë parasysh rritjen eksponenciale të promovimit të turizmit si dhe pozicionin gjeografik për të zhvilluar sporte të ndryshme tokësore, ujore dhe ajrore, ne besojme që Vlora do të shpallet fituese e këtij çmimi.

Shpresëplotë se ky aplikim do të gjejë miratim unanim në Këshillin Bashkiak, dhe si rrjedhojë Vlorës do t'i jepet mundësia për të qënë vend organizator i këtij eventit sportiv dhe gjithëpërfshirës.

Sinqerisht,



---

Klevis Kaso, Nënkyetar i Bashkisë Vlorë